

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: " Pjese kembimi per elektrovincat 1,2,3"

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor "**Autoriteti Portual Durres.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

A. CERTIFIKIMI I KOMPANISE PRODHUESE

1. Kompanite prodhuese te produkteve te ofruara "**Pjese kembimi per elektrovincat 1,2,3**", kerkohen te jene te certifikuara ,sipas normave **ISO 9001-2015** te standarteve nderkombetare te menaxhimit te cilesise dhe/ose te njevlershme ,te cilat do te garantojne nje sistem cilesor ne procesin e prodhimit te produktit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Duke qene se paisjet e kerkuara jane per sistem sigurie si dhe teknologjia e kerkuar eshte e nje niveli te larte duhet qe subjektet zbatuese te kontrates te jene te pajisura me keto certifikime.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/çertifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përmbushja e standartit ISO 9001 2015 ose ekuivalent është i rëndësishëm për të siguruar menaxhimin e cilësisë së shërbimeve që kerkohen. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standarteve të cilësisë.

2. FUSHA E VEPRIMTARISE

1. Fusha e veprimtarise se OE duhet te perkoje me objektin e kontratës që prokurohet e cila duhet të jete pjese e veprimtarise se Operatorit ekonomik,pers me siper OE duhet te kete te pershkruar ne objektin e veprimtarise se tij **Tregtim te pjeseve te kembimit mekanike elektrike dhe elektronike per makinerite e renda, vinça portual, elektrovinça,makineri industriale etj,**

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është e nevojshme për të vërtetuar që operatorët kanë në objektin e veprimtarisë së tij fushën e kontratës që po prokurorët.

3. KAPACITETI EKONOMIK DHE FINANCIAR:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, të lëshuar nga Administrata Tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare (2019-2020-2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurorët.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

4. KAPACITETI TEKNIK

1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë jo më pak se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurorët dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se "Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

5. Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve te prodhuesit/ve per listen e mallrave objekt prokurimi, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen.

-Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lehtesisht dhe qarte qe jane pjese katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

-Dokumentin e titulluar Ofertë Teknike te paraqitur nga Autoriteti Kontraktor ne formën e një tabele kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi artikujt e Listës.

Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;

-Emri i kompanisë prodhuese ose distributor i autorizuar nga prodhuesi me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në dokumentat e ofertimit. Adresa dhe web-sit të sakta të kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar.

-Emërtimi i Katalogut të prodhuesit.

Nr.i faqes në katalog referuar Nr.Idetifikues te artikullit të ofruar sipas listës ishenuar me nje shenje dalluse.

Argumentim: Keto kritere jane te nevojshme per AK qe te kete infomacione te detajuara per mallin qe i ofertohet nga Operatori ekonomik.

6. Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues ne ditën dhe oren e hapjes se ofertave duhet te paraqese mostra per zerat:

Nr	Emertime	Njesia	Sasia
1	Sinamics Control Unit CU320	cope	1
2	Basic Operator Panel BOP20	cope	1
3	Bobine Shunt	cope	1
4	Memory Card per CU320	cope	1
5	IGBT VCE-1200V IC430A	cope	1

Argumentim: Keto kritere jan te nevojshme per Autoritetin Kontraktor qe te kete siguri dhe vertetsi ne mallrat e ofertuar nga Operatori Ekonomik.

7. AFATI I LEVRIMIT

1. Afati i lëvrimit kërkohet të jetë për një periudhë prej 12 mujore nga dita e lidhjes së kontratës.

2. Kushtet e **marrveshjes kuader** janë të percaktuara, cmimet për mallrat që kërkohet të prokurohen janë të qëndrueshme, nuk ndryshojnë gjatë vitit.